



INSTITUTI ARKEOLOGJIK I KOSOVËS
Nr. 88/03
Dt. 02.06.2009
PRISHTINE

INSTITUTI ARKEOLOGJIK I KOSOVËS
ARCHAEOLOGICAL INSTITUTE OF KOSOVA

Per : z. Burbuqe Bakia – Deva, Udhëheqëse e DTK-MKRS

Lënda: Raport për vizitë pune në Kalanë e Harilaqit

Ekipi në përbërje nga Dr.Sc. Enver Rexha, Luan Gashi dhe Afrim Harullahu me datën 01.06.2009, vizituan për herë të dytë Kalanë në Harilaq, përkatësisht punët në konservimin e Kalasë. Punët konservuese realizohen nga ARTing- Injineri-Consulting, Behar Nela ing. i ndërtimtarisë. Gjatë punëve konservuese dyjavore janë realizuar përafërsisht 220-240 m². Ekipi punues ishte në përbërje nga gjithsejtë 11 punonjës, duke qenë nën mbikëqyrjen përhershme nga arkitekti si dhe herë pas herë, sipas nevojës, nga arkeologu Shkëlzen Saraqini. Punët konservuese momentalisht realizohen në verilindje dhe juglindje të objektit, përkatësisht në objektet binake “Pagëzimore”. Mendimi i ekipit mbikëqyrës qëndron si në vijim:

Punët konservuese të zhvilluara deri më tani janë duke u kryer në nivel të duhur, duke u ruajtur shtresa arkeologjike si dhe origjinalit i mureve ekzistuese në çdo aspekt, si llaqi me ngjyrë autentike si dhe fugatimi i brendshëm i lidhjeve gurore.

Po ashtu ju njoftojmë se, ARTing- Injineri-Consulting, z.Behar Nela, njoftoi me kohë DTK – MKRS për fillimin e punëve. Këtëj, ekipi nga Instituti Arkeologjik, edhe pse i përcaktuar nga DTK-MKRS për mbikëqyrje, deri më tani nuk ka një Vendim ligjor të lëshuar nga Zyra Ligjore e MKRS për vëzhgimin e veprimtarisë në objektin në fjalë.

Me respekt,

Prishtinë, më 01/06/2009

Drejtor
Dr. sc. Enver Rexha